Kronikë

Sulmi me 30 plumba drejt biznesit në Laç, pronari: M'u duk si zhurmë fishekzjarresh! Kamerat u stakuan kur mbërritën autorët, është frikë të jetosh në shtëpinë tënde

Ferhat Tugaj, pronari i biznesit që u sulmua me armë zjarri në Gjormë të Kurbinit mbrëmjen e së mërkurës, thotë se nuk ka pasur asnjëherë konflikte. Në fjalën e tij për mediat tha se breshëria e automatikut iu duk si zhurmë fishekzjarreje por reagoi pasi ishte më e fortë se aq.

Foto nga dyqani që u qëllua me breshëri plumbash

Redaksia
21 Prill, 19:57 | **Përditësimi: 21 Prill, 20:40**

Ferhat Tugaj, pronari i biznesit që u sulmua me armë zjarri në Gjormë të Kurbinit ***mbrëmjen e së mërkurës***, thotë se nuk ka pasur asnjëherë konflikte. Në fjalën e tij për mediat tha se breshëria e automatikut iu duk si zhurmë fishekzjarreje por reagoi pasi ishte më e fortë se aq.

Ai tregon se kamerat e sigurisë fikur pak sekonda para se të nisnin të shtënat ndaj është fiksuar vetëm momenti kur makina e autorëve mbërrin para biznesit. Tugaj thotë se policia e Lezhës nuk po kujdeset për rastin ndaj planifikon që të bëjë ankimim në Tiranë.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Kishte mbjellë kanabis prapa banesës së tij, arrestohet një person në Kurbin! Pamjet me dron zbuluan lëndën narkotike (EMRI)

"Rreth orës 23:00, 23:20 të darkës, unë kam shkuar te dhoma ime. Mami doli dhe iku se i kemi shtëpitë ngjitur këtu, as u bëngë 10 minuta kur u dëgjua breshëria e automatikut. Unë me mend se janë fishekzjarre se bëhet ndonjëherë ndonjë ditëlindje. E pashë që ishte më e fortë dhe normalisht u dëgjua shumë si zhurmë, u frikësova me thënë të drejtën. Nuk e di se si është puna, ku është puna, por me thënë të drejtën jam i tronditur. E kuptova se është thjesht një tip atentati ose ndonjë diçka për t'u frikësuar se normalisht një që ka diçka me mua personale vjen më kap mua, s'ka nevojë të vijë t'i fusë plumba biznesit. U çova, erdhi dhe mami, pastaj normalisht mora policinë. Konflikte s'kam pasur kurrë në jetën time. Më bën përshtypje shumë reagimi i vonshëm shumë.

Ngjarja ka ndodhur që parmbrëmë. Ata s'kanë ardhur të marrin kamerat e shtëpisë time, imagjino, prej këtu deri në Laç ke 30 biznese. Të gjithë kanë kamera. U mërzita dje, shkova te Drejtoria e Lezhës për të bërë një ankimim më tepër. Tani e kam në plan të shkoj në Tiranë, të bëj ankimim dhe atje. Atje nuk më pritën në Lezhë, kërkova drejtorin, drejtori kishte punë se ishte në një ngjarje tjetër. Unë mendoj se në Shqipëri nuk ka shtet, sepse besoj unë, ka funksionuar e do funksionojë gjithmonë miku, kush ka lekë e të bëjë diçka më plus, kush s'ka lekë ngelet në vend. Kur hapa kamerat për të parë ngjarjen, shifet shumë qartë makina që vjen këtu, ndalohet para oborrit aty edhe fiks 4-5 sekonda vetëm stakohen kamerat edhe mbrapa dëgjohet breshëria, domethënë nuk e ka kapur fare", tha Tugaj.

Ai shtoi se nuk mund të vërë gishtin tek askush për ngjarjen ndërsa e konsideron shqetësuese situatën.

"Të kesh frikë të jetosh në shtëpinë tënde, në hallet e tua, në shtëpinë tënde. Dyshimet e mia me thënë të drejtën nuk kam asnjë. Asnjë dyshim tek kurrkush. Dua drejtësi, vetëm drejtësi, kushdo që të jetë autori të shkojë te vendi ku i takon. Të paktën të rrish i qetë në punën tënde. Taksat i paguaj, kur vjen puna s'ke asnjë lloj sigurie", tha Tugaj.

Pronari i biznesit u shpreh se ka rreth 7-8 mijë euro dëme. Nga raportimet mësohet se drejt biznesit është qëlluar me rreth 30 plumba.

A.M./Shqiptarja.com

TAG: Ferhat Tugaj | Kurbin | Lezhë | sulm me armë

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

[Sh.com]

Sondazhi i ditës:
1 javë fushatë elektorale, cila palë ka kandidatët më të mirë?

PS | PD | Berisha-Meta

Lajme të tjera

Vrasja e Nikulajt në Shëngjin, u mbajt në vëzhgim 1 javë! Kamerat fokusuan një person me veshje të njëjtë si autori! Dëshmitë e punonjësve: Na tha 'si kaluat' dhe e qëlloi
21 Prill, 11:47

Sherr me thika në Rrëshen, dy të rinj plagosin njëri-tjetrin pas debateve për motive banale
21 Prill, 11:21

Të shtëna me armë zjarri në drejtim të një biznesi në Laç! Autorët qëlluan me 30 plumba
20 Prill, 19:32

EKSKLUZIVE/ VIDEO E PLOTË nga momenti kur vritet biznesmeni në Shëngjin, autori profesionist përshëndet viktimën, afrohet dhe qëllon 7 herë! Roja shtangu
20 Prill, 19:24

Vrasja e Nikulajt në Shëngjin, bllokohet një motor i ngjashëm me atë të autorit në Tiranë! Hasmëria me fisin Palaj, pistë hetimi
20 Prill, 11:32

Vrasja e biznesmenit në Shëngjin, Ministri i Drejtësisë: Autoritetet të zbardhin ngjarjen! I përgjigjet Berishës: Neveri, përdor ngjarjen për politikë
20 Prill, 09:58

Ungrej i Lezhës, fshati që s'ka rrugë për në varreza! Banorët: Me arkivol në krah ecim një orë në këmbë
19 Prill, 18:05

Ekzekutohet duke pirë kafe në lokalin e tij biznesmeni politikan në Shëngjin, anëtar i PSD për Këshillin Bashkiak Lezhë! FOTO nga momenti i vrasjes! Ja pistat e hetimit
19 Prill, 13:40

Banorët e fshatit Kaçinar kundër HEC-eve në Mirditë, u rikthehen protestave: Edhe në kohën e Enverit s'na kanë lënë pa ujë
Elvis Hila
16 Prill, 13:51

PD hap fushatën elektorale në Lezhë, Bardhi: Rithemelimi po fuqizon Metën që solli në pushtet Ramën në vitin 2013! Në këtë betejë të pazakontë jemi për të ruajtur dinjitetin
16 Prill, 09:45

Aksident në Lezhë, ambulanca përplaset me 'Ford-in'! Shoferi i makinës përfundon me urgjencë në spital
16 Prill, 07:17

Prag sezoni, në Shëngjin mungojnë punëtorët! Palokaj: 20 mijë vende pune në hoteleri-turizëm
Elvis Hila
15 Prill, 17:20

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje